

**AKT THEMELIMI**  
**i**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“Adam Construction Company” SH.P.K**  
**Neni 1**  
**Emri**

- 1.1 Sot, më datë 06.06.2022 krijohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, emri i së cilës është **“Adam Construction Company” Sh.p.k**, në vijim e referuar shkurt si **“Shoqëria”**. Emri tregtar i shoqërisë është **Adam Construction Company**.

**Neni 2**  
**Themelimi.**

- 2.1 Shoqëria themelohet bazuar në legjislacionin shqiptarë në fuqi dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar, me këtë Akt Themelimi dhe me Statutin e saj.

**Neni 3**  
**Selia**

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga “Mine Peza”, H2, Kt 2 , Apt 4, Njesia Administrative Nr 9 ,Tirane. Shqiperi.
- 3.2 Shoqëria mund të hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme përveç selisë së Shoqërisë brenda territorit Shqiptar.

**Neni 4**  
**Ortakët e Shoqërisë**

- 4.1 Ortakët dhe themeluesit e Shoqërisë janë:
1. **MAMDOUH MOHAMED YEHIA ZAKARIA** shtetas Egjiptian lindur me 25.11.1965 ne Dakahliya identifikuar me pasaport Nr. A29409198 zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë, me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara në shumën prej **10.000 LEKE** (*dhjete mije leke*), të cilat përfaqësojnë **100 %** të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

**Neni 5**  
**Kapitali Themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën **10.000 Lekë** (*dhjete mije leke*),i ndarë në **1 (nje) kuot**, me vlerë sipas nenit 4 me sipër.

- 5.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para, plotësisht të nënshkruara dhe paguara dhe zotërohet nga ortakët e Shoqërisë sipas Nenit 4 të këtij Akti Themelimi.
- 5.3 Kuotat, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme dhe pas ushtrimit të së drejtës së parablerjes ndaj ortakëve të tjerë të Shoqërisë sipas parashikimeve statutores, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër dhe forme të parashikuar nga ligji dhe/ose statutit.

## **Neni 6** **Objekti**

6.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin si më poshtë vijon: “ Shërbime të ndryshme në fushën e zhvillimit urban dhe ndërtimit. Shoqëri shërbimesh Profesionale. Konsulencë, Menaxhim Projekti etje. Tregtim dhe Shërbime Mobilerie. Ndërtime Civile e Industriale, Rikonstruksione Objektsh, Dekorime, Pajisjen me instalimet përkatëse elektrike, hidrosanitare. Shërbime Marketingu dhe Konsulencë si dhe çdo aktivitet tjetër i cili realizon të ardhura dhe nuk bie në kundërshtim me ligjet Shqipëtare”.

## **Neni 7** **Kohëzgjatja**

- 7.1 Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## **Neni 8** **Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar në, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit/ëve kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit, etj sikurse parashikohet në Statut dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.

## **Neni 9** **Administrimi i Shoqërisë**

- 9.1 Administratori/ët e parë të Shoqërisë janë:

**1. MAMDOUH MOHAMED YEHIA ZAKARIA** shtetas Egjiptian lindur me 25.11.1965 ne Dakahliya identifikuar me pasaport Nr. A29409198 madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar.

**2. MOSTAFA ABDELKHALEK ABDELFATTAH ABOUELFETOUH** shtetas Egjiptian lindur me 15.09.1984 ne Cairo identifikuar me pasaport Nr. A24036823 madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar.

9.2 Administratori/ët emërohen për një periudhë **5** (pesë) vjeçare, me të drejtë riemërimi. Administratorët emërohen dhe/ose shkarkohen nga detyra, në çdo kohë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë.

**Neni 10**  
**Ligji i Zbatueshëm**

- 10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 10.2 Çdo konflikt që mund të lindë mes ortakëve të Shoqërisë në lidhje me, ose si rrjedhojë e këtij akti themelimi do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**ORTAKU I VETEM**  
**THEMELUES**

\_\_\_\_\_  
**MAMDOUH MOHAMED YEHIA ZAKARIA**

MAMDOUH MOHAMED YEHIA ZAKARIA

MAMDOUH  
